



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 30, dt. 08.03.2017

Në mbështetje të nenit 47 të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e 08.03.2017, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit "Olea Rezidencë Dhërmi" Himarë, me subjekt aplikues administratorët Artan Dumi dhe Mirela Papuli.
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e objektit monument kulture:
Projekti i restaurimit të kishës dhe pikturës murale, tavanit "Kisha Ipapandisë", Dhërmi, Himarë sipas projekt-preventivit që është hartuar nga specialistët e DRKK Vlorë dhe IMK.
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, dt. 07.04.2003 "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

SEKRETAR I KKR I DELEGUAR

ARTA DOLLANI